



Partia Demokratike e Shqipërisë

KALLËZIM PENAL

Tiranë, 23/02/2021

KALLËZUES: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Z. Gazment Bardhi, Sekretar i Përgjithshëm

OBJEKTI: Kallëzim i veprës penale të “Korrupsioni aktiv në zgjedhje” parashikuar nga neni 328, dhe “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” parashikuar nga neni 328/a, i Kodit Penal.

KUNDËR: [REDAKTUAR], Deputet i Kuvendit të Shqipërisë, Drejtues Politik i Partisë Socialiste për Qarkun [REDAKTUAR]

Cdo person i pa identifikuar deri me tani nga ana jone por qe me veprime konkrete rezulton mbas hetimit qe ka pergjegjesi penale.

BAZA LIGJORE: Nenet 75/a, 280, 283 e vijues të K.Pr.Penale, neni 328, 328/a i Kodit Penal, Neni 91 i Kodit Zgjedhor, nenet 8, 9, 10 e vijues të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”,

DREJTUAR: PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT - SPAK.

I ndertuar Z. Drejtues i Prokurorisë,

Bazuar në nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale, po ju parashtrojmë këtë kallëzim penal për veprën penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, dispozitat ligjore penale të cënuara, si dhe analizën juridike dhe provat me anë të të cilave vërtetohet konsumimi i veprës penale.

RRETHANAT E FAKTIT:

Siç jeni në dijeni në 25 Prill do të zhvillohen zgjedhjet parlamentare dhe prej disa kohësh ka filluar organizimi partiak i subjekteve zgjedhore ku nëpër qarqe të ndryshme janë deleguar dhe drejtuesit sipas partive politike.

Shtetasi [REDAKTUAR] është caktuar drejtues politik i Qarkut të [REDAKTUAR] për Partinë Socialiste dhe gjithashtu mbanë edhe detyrën e [REDAKTUAR] të kësaj partie si dhe Kryetar i [REDAKTUAR]

Të gjitha detyrat e këtij shtetasi i përmendem për faktin e vetëm për të treguar që ky shtetas në veprimtarinë e tij shtetërore apo politike nuk ka asnjë lidhje me ndihmën ekonomike të familjeve në nevojë. Mirëpo, duke shfrytëzuar vendimin nr. 85, datë 10.02.2021 të Këshillit të Ministrave, shtetasi [REDAKTUAR] ka përdorur dyfishimin e përkohshëm të ndihmës ekonomike për përfitime politike.